



Mbrojtja e Privatësisë në Epokën Digjitale

Anxhela Lepuri

Hyrje

Ky artikull trajton mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtave që lidhen me të, në një kohë kur zhvillimi teknologjik është më i prekshëm në jetën e përditshme. Me këto ndryshime lind nevoja e diskutimit mbi sigurinë e të dhënave tona, kryesisht në rrafshin *online*. Bashkimi Evropian konsiderohet pararojë në mbrojtjen e të dhënave, privatësisë dhe sigurisë kibernetike përmes adoptimit të GDPR (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale).

Konteksti i përgjithshëm

Me zhvillimin e teknologjisë ka patur përpjekje për të krijuar një sistem të plotë të mbrojtjes së të dhënave në të gjithë Evropën dhe më gjërë, duke filluar në vitin 1980, kur Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) lëshoi rekomandimet për udhëzimet që rregullojnë mbrojtjen e privatësisë dhe flukset ndërkufitare të të dhënave personale. Shtatë parimet që përmbajnë rekomandimet e OECD-së për përpunimin e të dhënave personale ishin njoftimi, qëllimi, pëlqimi, siguria, përhapja, aksesit, dhe llogaridhënia.

Megjithatë, udhëzimet e OECD-së nuk janë të detyrueshme dhe ligjet e të dhënave personale ndryshonin gjerësisht në të gjithë Evropën. Komisioni Evropian gjykoj se divergjencat në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave midis shteteve anëtare të BE-së pengojnë lëvizjen e lirë të të dhënave brenda BE-së dhe nuk garantojnë të njejtin standard mbrojtjeje. Në këto rrethana, Komisioni propozoi hartimin e Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Direktiva shprehej se shtetet anëtare duhet të garantojnë të drejtën për jetë private për sa i takon përpunimit të të dhënave personale dhe gjithashtu nuk



duhet të kufizojnë apo ndalojnë qarkullimin e lirë të të dhënave personale ndërmjet shteteve anëtare.

Si pasojë e ndryshimeve të ndodhura në kohë dhe dinamikave të reja, u pa nevoja për përditësimin e kornizës ligjore përmes adoptimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), e cila konsiderohet si rregullimi më i plotë për sa i përket mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë së të dhënave. GDPR synon krijimin e një kuadri ligjor të harmonizuar për mbrojtjen e të dhënave brënda BE-së, pa penguar lëvizjen e lirë të tyre. Gjithashtu, shtetet anëtare të BE-së janë nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ku në nenin 8 njihet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij.

GDPR-i nuk rregullon vetëm veprimtarinë e ndërmarrjeve të themeluara në BE por zbatohet për të gjitha kompanitë që përpunojnë të dhëna personale qytetarëve që banojnë në BE ose Zonën Ekonomike Evropiane, pavarësisht nga vendodhja e ndërmarrjes. Pra logjika e GDPR-it është të ndjekë zotëruesin e të dhënave, jo përpunuesit e tyre. Në thelb, të gjitha ndërmarrjet dhe organizatat duhet të jenë në përputhje me GDPR-in për sa kohë që përpunojnë të dhënat e qytetarëve të BE-së.

Gjithashtu, GDPR-i mbron cdo individ jo-shtetas të BE-së por që ndodhet në BE. Pra, nëse një qytetar nga cilido shtet udhëton në një nga vëndet e BE-së, trajtimi i të dhënave të tij duhet të jetë në përputhje me kërkesat e GDPR-it për sa kohë ata qëndrojnë në atë vend. Shqipëria, në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, duhet të përshtasë kornizën ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave digjitale me standartet e BE-së.

Kur lejohet përpunimi i të dhënave?

Sipas GDPR-it, përpunimi i të dhënave është i ligjshëm kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e posaçëm dhe të qartë për përpunimin. Dhënia e pëlqimit përbën kusht të domosdoshëm në përpunimin e të dhënave personale. Për të garantuar kuptueshmërinë, përpunuesit e të dhënave nuk duhet të përdorin terma apo forma të ndërlikuara për të kërkuar pëlqimin nga klientët.



Shpesh, përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për të kryer një detyrë në interes publik ose në rastet për të kryer një funksion zyrtar, pasi të jetë përcaktuar interesi i ligjshëm për përpunimin e të dhënave në përputhje me parimin e transparencës. Megjithatë, të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave i tejkalojnë interesat e përpunuesit të të dhënave.

Të drejtat e privatësisë së individëve

GDPR-i njih një sërë të drejtash të reja të privatësisë për subjektet e të dhënave të cilat synojnë tu japin individëve më shumë kontroll mbi të dhënat që u huazojnë përpunuesve.

Së pari, njih të drejtën për tu informuar para se të dhënat të mblidhen, ruhen ose përpunohen. Gjithashtu, njih të drejtën e aksesit që do të thotë se subjekti i të dhënave mund të kërkojë konfirmim nga përpunuesit nëse të dhënat e tij po përpunohen dhe për qëllimin e përpunimit.

Subjekti i të dhënave ka të drejtën e korrigjimit, plotësimit, përditësimit, apo fshirjes së të dhënave të tyre personale. Ndër të tjera njih të drejtën për të kufizuar përpunimin e të dhënave, të drejtën për të kundërshtuar apo ndaluar përpunimin e të dhënave nga përpunuesit, dhe të drejtën për të shmangur vendimarrjen e automarizuar.

Risi

GDPR-i ka sjellë disa risi në rregullimin e mbrojtjes së të dhënave personale, disa prej të cilave shtjellohen më poshtë.

Njoftimet për shkeljet – Në rast të shkeljeve apo rrjedhjeve të të dhënave, direktiva detyron përpunuesit e të dhënave të njoftojnë autoritet mbikëqyrëse dhe subjektin e të dhënave brenda 72 orëve pas zbulimit të shkeljes.

Oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave – Oficeri për mbrojtjen e të dhënave ofron mbështetje ndaj përpunuesve lidhur me përshtatshmerinë e veprimtarisë së tyre duke marrë rolin e ndërmjetësit midis përpunuesit dhe autoriteteve mbikëqyrëse/subjekteve të të dhënave. Autoritetet publike duhet të emërojnë një officer të mbrojtjes së të dhënave. Gjithashtu, kjo vlen për ndërmarrjet/organizatat që angazhohen në monitorim në shkallë të gjërë të



klientëve, siç është gjurmimi i sjelljes në internet apo për ndërmarrjet/organizatat që angazhohen në perpunimin në shkallë të gjërë të të dhënave të ndjeshme si të dhëna personale që zbulojnë origjinën racore, etnike ose besimet fetare.

Përfundime

GDPR, i cili tashmë njihet si një ndër ligjet më të rrepta në botë mbi privatësinë dhe sigurinë e të dhënave personale, parashikon gjoba të mëdha ndaj entiteteve të cilat shkelin standartet e sigurisë dhe privatësisë. Detyrimi për të qenë në përputhje me dispozitat e direktivës bie mbi çdo ndërmarrje/organizatë që proceson të dhëna të qytetarëve të vendosur në vendet e BE-së.

GDPR është përshtatur ndaj ndryshimeve të gjëra të orientuara drejt sigurisë. Për rrjedhojë, organizatat, bizneset dhe madje edhe sipërmarrësit individual, përfshirë edhe në Shqipëri, do të duhet të respektojnë një grup të plotë rregullash dhe detyrimesh ligjore për të garantuar mbrojtjen e të dhënave të klientëve të tyre. Mbrojta e të dhënave është e lidhur fort me zbatimin e masave gjithëpërfshirëse të shtjelluara në këtë shkrim, si përgjigje nda kërcënimeve kibernetike të të gjitha formave. Kështu qytetarëve iu është dhënë më tepër pushtet për sa i përket përdorimit të të dhënave të tyre.

Shqipëria gjithashtu e ka përshtatur kornizën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e GDPR-it, por nga ana praktike ka shumë për të përmirësuar në mënyrë që qytetarët vendas apo vizitorë nga vënde të ndryshme të ndihen të sigurtë se të dhënat e tyre do të trajtohen dhe mbrohen sikurse e parashikon ligji.

Burime;

1-Boardman R., Mullock J., Mole A.,

"Guide to General Data Protection Regulation", Bird& Bird Publications,2020.

2-<https://idmalbania.org/sq/raport-studimor-tejkalimi-i-hendekut-mes-sigurise-kibernetike-dhe-te-drejtave-te-njeriut/>

3-https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/ligji_9887_per_mbrojtjen_e_te_dhenave_personale.pdf



Institute
for Democracy
and Mediation



Hanns
Seidel
Stiftung

4-<https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2023/02/Data-breach-1.pdf>

5-https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/ligji_9887_per_mbrotjen_e_te_dhenave_personale.pdf

6-https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/ligji_9887_per_mbrotjen_e_te_dhenave_personale.pdf

7-<https://gdpr.eu/tag/gdpr/>

8-<https://www.forbes.com/sites/forbestechcouncil/2018/12/19/data-privacy-vs-data-protection-understanding-the-distinction-in-defending-your-data/?sh=2d16c86e50c9>